



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 26, datë 27.11.2024

**PËR
MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT DHE NDRYSHIMIT TË PROJEKT GJATË
NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË POLIFUNKSIONALE 4, 5, 11 DHE 21 KATE,
ME 3 DHE 4 KATE NËNTOKË “BOOK BUILDING”, NDËRMJET RRUGËS “28
NËNTORI” DHE RRUGËS “ABDI TOPTANI”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Techno-Alb” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit dhe ndryshimin e projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Godinë polifunksionale 4, 5, 11 dhe 21 kate, me 3 dhe 4 kate nëntokë “Book Building”, ndërmjet rrugës “28 Nëntori” dhe rrugës “Abdi Toptani”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Techno-Alb” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 26/03/2025